

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Specialist** pranë OSSH / Drejtori Rajonale / Dega e Shërbimeve Mbështetëse.

SPECIALIST

Të ofrojë suport teknik dhe administrativ në fushën e informatikës, duke siguruar funksionimin normal të pajisjeve, sistemeve dhe aplikacioneve informatike në mbështetje të proceseve të punës së Drejtorisë Rajonale.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ofron suport teknik për stafin e Drejtorisë Rajonale për pajisje kompjuterike, printera, skanerë dhe pajisje të tjera IT.
- Mirëmban dhe monitoron funksionimin e rrjetit lokal (LAN) dhe lidhjeve bazë të komunikimit.
- Asiston në instalimin, konfigurimin dhe përditësimin e software-ve dhe aplikacioneve zyrtare të përdorura nga shoqëria.
- Evidenton, diagnostikon dhe raporton problematikat teknike, duke bashkëpunuar me strukturat qendrore të IT-së.
- Administron përdoruesit, akseset dhe pajisjet informatike sipas rregulloreve dhe udhëzimeve në fuqi.
- Kujdeset për sigurinë bazë të informacionit, ruajtjen e të dhënave dhe respektimin e politikave të sigurisë IT.
- Përgatit raporte periodike mbi gjendjen e pajisjeve dhe nevojat për mirëmbajtje ose zëvendësim.
- Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga eprori, në funksion të veprimtarisë së Degës së Shërbimeve Mbështetëse.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Diplomë në Informatikë, Teknologji Informacioni ose fusha të ngjashme.
- Jo më pak se 3 vite eksperienc pune.
- Njohuri bazë/mesatare në sisteme operative Windows, rrjete kompjuterike dhe pajisje IT.
- Aftësi për të punuar në ekip dhe për të ofruar shërbim mbështetës ndaj përdoruesve.
- Aftësi të mira organizative dhe komunikimi.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.